



# MANUAL PERDORIMI

## Expert 01

## PERMBAJTJA

1. Pajisja juaj fiskale .....	3
1.1 Libri fiskal.....	3
1.2 Transmetuesi i te dhenave (modemi) .....	4
1.3 Sigurimi i punes dhe mbrojtja e ambientit .....	5
2. Funksione te pergjithshme .....	6
3. Perpara se te filloni .....	7
4. Shitje me cmim te fiksuar .....	8
5. Shitje me cmim te ndryshueshem.....	8
6. Shitje me fature tatimore (TVSH) .....	8
7. Z Raport (mbyllje ditore) .....	9
8. Gabim 109 .....	10
9. Printim raporti periodik .....	11
10. Lexim kopje kuponit (kopje jo tatimore) .....	11
11. Ndryshimi i ores .....	12
12. Programimi i artikujve .....	12
12.1 Ndryshimi i te dhenave te artikujve .....	13

## 1. PAJISJA JUAJ FISKALE

Pajisja juaj fiskale mban emrin Daisy Expert 01 dhe shoqerohet me pajisjet dhe aksesoret e meposhtem (fig. 1):



Fig.1

1. Karikuesi i kases fiskale
2. Kasa fiskale (detajuar ne fig.3 dhe 3/1)
3. Transmetuesi i te dhenave (modemi) (detajuar ne fig.4)
4. Fisha lidhese kase-modem
5. Ushqyesi i Modemit

### 1.1 LIBRI FISKAL (fig.2)



Fig.2

Libri fiskal eshte "pasaporta" e pajisjes suaj dhe duhet te shoqeroje gjithnje kasen fiskale. Cdo here qe do te paraqiteni prane servisit per riparim te pajisjes duhet ta keni me vete pasi ne liber do te shenohen nga tekniku i autorizuar te gjitha nderhyrjet qe i behen pajisjes.

#### **Ju nuk duhet te beni asnje shenim ne librin fiskal.**

Eshte e rendesishme te mos e humbisni.

Ne rast demtimi apo humbje te librit duhet te drejtoheni prane Drejtorise Rajonale Tatimore perkatese per te kerkuar pajisjen me dublikat te librit.




### 1. Vula e teknikut.

Kjo vule tregon paprekshmerine e pajisjes dhe nuk duhet te preket. Nese vula eshte e prishur do te thote se ne pajisje eshte nderhyre nga persona te paautorizuar.

2. Qarku i Shiritit te Kontrollit Elektronik (QSHKE), eshte memorja e jashtme e pajisjes dhe ruan gjithe kuponat tatimore te prere ne pajisjen tuaj. **KUJDES!** Kjo pjese e kases nuk duhet te preket pasi nese del jashte pajisjes gjate perdorimit te saj rrezikon te digjet dhe i gjithe informacioni fiskal i ruajtur ne te do te fshihet.

3. Pjesa e prapme e kases ku ndodhen Ekran i klientit, Vendi i karikimit, dhe portat e komunikimit



## 1.2 Transmetuesi i te dhenave (modemi)

Modemi GPRS eshte pajisja me ane te te cilit behet transmetimi i te dhenave te kases tek server qendror i Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve. Me poshte paraqitet Modemi me pjeset perberese te tij.




Fig.4

### **1.3 SIGURIMI I PUNES DHE MBROJTJA E AMBJENTIT**

#### **1.3.1 UDHEZIME PER PUNE TE SIGURTE**

Pajisja juaj ka nje garanci prej 12 muajsh e cila perfshin difektet te cila vijne nga prodhuesi ose jane te pavarura nga menyra e perdorimit. Per te siguruar nje funksionim normal te kases fiskale duhet te permbushen kerkesat e meposhtme. Nese nuk respektohen kushtet e listuara me poshte kompania tregtuese dhe prodhuese nuk mban pergjegjesi per mos – funksionimin e pajisjes:

- Ndiqni hap pas hapi udhezimet e ketij manuali, sidomos ne momentet e para te perdorimit te kases. Konsultimi i vazhdueshem me manualin derisa te pervetesoni mjaftueshem te gjitha funksionet e pajisjes eshte i nevojshem per te evituar gabime ne fatura dhe demtim te pajisjes suaj.
- Mos instaloni kasen prane ambienteve me lageshti dhe avull te nxehte.
- Mos e pastroni ose lani me uje ose lengje.
- Mos e instaloni kasen ne vende te pa qendrushme ose siperfaqe me vibrim.
- Mbroni kasen nga goditjet dhe demtimet mekanike.
- Mos prekni mekanizmin e printimit, kur ajo eshte duke punuar
- Ushqimi me energji elektrike duhet te jete 220 (+20 -10%) V, 50 Hz. Prodhuesi ose partneri shperndares nuk do te mbaje pergjegjesi per mos funksionimin normal te kases per shkak te jostabilitetit te furnizimit elektrik.
- Para perdorimit te pare sigurohuni te kryeni ciklin e baterise duke e shkarkuar te gjithe baterine ne pajisje dhe duke e vendosur me pas ne karikim per 12

ore. Pasi te jete karikuar plotesisht, hiqeni nga karikimi dhe vazhdoni te punoni me bateri derisa te shkarkohet serisht. Karikoheni perseri pajisjen dhe vazhdoni punen normalisht.

- Procedura e pastrimit duhet te behet vetem kur paisja eshte e fikur.
- Mirembajtja e paisjes do te behet vetem nga persona te autorizuar nga DAISY technology.
- Ne qofte se kasa nuk punon, hiqni spinen nga tensioni dhe njoftoni sherbimin e autorizuar.

### 1.3.2 **MBROJTJA E AMBJENTIT**

Ndalohet retpesisht hedhja e kases ne vende te pa regullta.



## 2. **FUNKSIONE TE PERGJITHSHME**

Kasa fiskale ka 7 menyra operimi. Per te kaluar nga nje menyre operimi ne tjetren perdorim butonin MODE. Per te konfirmuar nje menyre te caktuar operimi kerkohet kodi dhe me pas shtypet butoni CLK. Kodi eshte i percaktuar nga fabrika dhe eshte 9999. Menyrat e operimit jane si me poshte

- SHITJE
- LEXIM (per leximin e nje kopje tekuponit, per printimin e raporteve jotatimore)
- Z RAPORT (per te bere raportimin e te dhenave ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve “mbylljen ditore”)
- PROG (Programimi i te dhenave ne kase)
- MF (Printim i raporteve periodike)
- PC (per te lidhur pajisjen me kompjuterin)
- TRAJNIM (per te bere prova shitjesh por pa shitur realisht artikuj)

#### ✓ **KASA FISKALE ka te instaluar:**

- Memorje fiskale - memorja fiskale e pavarur per sigurimin e xhirove per 4 grupe taksash dhe 1800 raporte ditore.

**SHENIM** : kur memorja fiskale mbushet, kasa fiskale bllokohet dhe printon vetem raporte .

- Oren dhe kalendarin

- Printerin termik ELM 205 / APS –MP 205 me shpejtesi printimi deri ne 72 mm /sek dhe 36 simbole per rresht – 18 per klientin dhe 18 per kontrollin.
- Tastieren me 39 butona (12 numerike dhe 27 me funksione)
- Kasa fiskale mban te dhena ne memorjen RAM deri ne 90 dite pas shkeputjes nga rrjeti elektrik.

#### ✓ Karakteristikat funksionale

- 4 grupe taksash
- 20 perdorues
- 8000 artikuj (PLU)
- 50 sektore artikujsh
- Skaner barkodi –EAN-8, EAN-13, UPC – A, UPC – E kode
- Temperatura - 20 °C deri + 45°C
- Ushqimi elektrik 220 V / 50 Hz: < 12 V
- Sinjal akustik < 55 dB
- Dimensionet 200 mm x 100 mm x 70 mm

### 3. PERPARA SE TE FILLONI

Sigurohuni qe karikuesi i kases fiskale te jete i vendosur ne menyre korrekte ne prize. Perpiquni te evitoni prizat treshe sidomos ato qe nuk bejne puthitjen e sakte te spines me prizen.



Artikujt qe ju tregtoni jane te regjistruar ne kase dhe mund t'i printoni ne cdo moment sipas udhezimit te meposhtem:

- Shtypim butonin “**MODE**” derisa ne ekran te shfaqet “**PROG**”
- Shtypim **9999**
- Shtypim butonin “**CLK**”
- Shtypim butonin “**PLU**”
- Shtypim butonin “**-%**”.
- Presim derisa te printohet e gjithë lista e artikujve ne te cilen shenohet ne fillim numri i artikullit, me pas emertimi i tij.



#### 4. SHITJE ME CMIM TE FIKSUAR

Kur artikujt ne kase i kemi regjistruar me cmim fiks do te ndjekim proceduren e meposhtme:

1. Shtypim butonin **MODE** derisa ne ekran te dale **“SHITJE ....”**
2. Shtypim numrin 9 kater here **“9999”**
3. Miratojme me butonin **“CLK”**
4. Ne ekran do dale **“0.00”**
5. Vendosim sasine e mallit qe po shesim (psh. 1)
6. Miratojme sasine me butonin **“QTY”**
7. Vendosim kodin e artikullit (psh. 2)
8. Miratojme kodin e artikullit me butonin **“PLU”**
9. Mbyllim faturen duke shtypur butonin **“TL”**
10. Ne perfundim ne ekran do te dale **“KESH”**

Nese kemi me shume se nje artikull ne fature para se te mbyllim faturen me butonin “TL” do te perseritim proceduren duke filluar nga pika 5.

#### 5. SHITJE ME CMIM TE NDRYSHUESHEM

Kur artikujt ne kase i kemi regjistruar pa cmim do te ndjekim proceduren e meposhtme:

1. Shtypim butonin **MODE** derisa ne ekran te dale **“SHITJE ....”**
2. Shtypim numrin 9 kater here **“9999”**
3. Miratojme me butonin **“CLK”**
4. Ne ekran do dale **“0.00”**
5. Vendosim sasine e mallit qe po shesim (psh. 1)
6. Miratojme sasine me butonin **“QTY”**
7. **Vendosim cmimin (psh. 100)**
8. **Miratojme cmimin me butonin “CLK”**
9. Vendosim kodin e artikullit (psh. 2)
10. Miratojme kodin e artikullit me butonin **“PLU”**
11. Mbyllim faturen duke shtypur butonin **“TL”**
12. Ne perfundim ne ekran do te dale **“KESH”**

Nese kemi me shume se nje artikull ne fature para se te mbyllim faturen me butonin “TL” do te perseritim proceduren duke filluar nga pika 5.

#### 6. SHITJE ME FATURE TATIMORE

Kjo menyre perdoret ne rastin e shitjes me nje fature TVSH e cila po paguhet me para ne dore dhe per te cilen duhet te presim kuponin tatimor:

1. Shtypim butonin **MODE** derisa ne ekran te dale **“SHITJE ....”**
2. Shtypim numrin 9 kater here **“9999”**
3. Miratojme me butonin **“CLK”**
4. Ne ekran do dale **“0.00”**
5. Vendosim **numrin serial** te fatures (numri me ngjyre te kuqe)
6. Miratojme me butonin **“ST”**
7. Ne ekran do dale shkrimi **“FATURA psh.12345678”** (numri serial qe keni vendosur ju)



8. Vendosim vleren e fatures perfshire TVSH
9. Miratojme vleren me butonin **“CLK”**
10. Vendosim kodin e artikullit “shitje me fature” (psh. 1)
11. Miratojme kodin e artikullit me butonin **“PLU”**
12. Mbyllim faturen duke shtypur butonin **“TL”**

Ne perfundim ne ekran do te dale **“KESH”**

## 7. **Z RAPORT (mbyllja ditore)**

Mbyllja ditore ose ndryshe i quajtur raportimi ditor “Z Raport” eshte menyra me ane te te ciles ju do te raportoni online ne Dretjorine e Pergjithshme te Tatimeve xhiron tuaj ditore. Ky eshte nje proces shume i rendesishem i cili duhet te kryhet cdo 24 ore ne menyre te detyrueshme, edhe kur nuk keni pasur asnje shitje ate dite.

Ne rastin qe nuk keni pasur shitje raportimi juaj do te shkoje ne sistem me vleren 0 (zero), dhe kjo eshte normale.

Ne rastet qe ju nuk e keni aktivitetin funksional per nje periudhe kohe (Pushime, Arsye personale etj.) dhe nuk do te mund te beni raportim ditor, nuk do te penalizoheni nga organet tatimore.

Perpara se te beni mbylljen ditore, **sigurohuni qe modemi dhe kasa fiskale te jete e vendosur ne prize**. Sigurohuni qe kasa dhe modemi te jene te lidhur me njeri tjetrin nepermjet fishes se bardhe lidhese.

Fisha e bardhe duhet te jete e vendosur tek modemi te porta “COM1” dhe tek kasa tek porta me shenjen e peshores siper.

Ndizni modemin duke mbajtur butonin e kuq shtypur deri sa te degjoni nje sinjal akustik “BIP” dhe ne modem te pulsoje drita jeshile.

Prisni derisa te pulsoje njehere drita e kuqe qe sinjalizon se tani modemi eshte gati te prese komanda nga kasa.



Pasi kemi pergatitur modemin si me siper fillojme veprimet ne kase si me poshte:

1. Shtypim butonin **MODE** derisa ne ekran te dale **“Z RAPORT ....”**
2. Shtypim numrin 9 kater here **“9999”**
3. Miratojme me butonin **“CLK”**
4. Ne ekran do dale **“Z RAPORT”**
5. Shtypim butonin **“TL”**
6. Ne ekran do te dale shenimi **“Connect....”**
7. Presim pa bere asnje veprim tjetet ne pajisje apo ne modem derisa te perfundoje transmetimi.

8. Nga kasa do te dale nje flete me te dhenat ditore dhe ne fund do te shkruaje **“Transmetimi OK”**. Kjo do te thote se te dhenat tuaja jane derguar ne DPT rregullisht.
9. Nese ne fund te fletes lexon **“Transmetimi Error”** do te thote se te dhenat e sotshme nuk kane vajtur ne DPT.

**Mos e perserisni proceduren** por te vazhdoni shitjet normalisht. Ky mesazh del per nje sere arsyesh te cilat ne shumicen e kohes jane te perkohshme dhe te nesermen kur te behet “Transmetimi OK” do te jene derguar dhe te dhenat e paderguara te nje dite me perpara. Ne se ndodh qe per 3-4 dite transmetimi eshte me ERROR atehere beni transmetimin manual te te dhenave si me poshte:

1. Shtypim butonin **MODE** derisa ne ekran te dale **“SHITJE ....”**
2. Shtypim numrin **“11”**
3. Miratojme me butonin **“TL”** dhe perseri butonin **“TL”**

## 8. **GABIM 109**

Ky shkrim del ne ekran kur keni bere 10 here njera pas tjetres Transmetime Error. Ne kete rast shtypim butonin “C” per te hequr shkrimin “Gabim 109” nga ekrani dhe vazhdojme si me poshte:

1. Sigurohuni qe **kasa fiskale te jete e vendosur ne prize.**
2. Sigurohuni qe edhe **modemi te jete i vendosur ne prize**
3. Sigurohuni qe kasa dhe modemi te jene te lidhur me njeri tjetrin nepermjet fishes se bardhe lidhese.
4. Fisha e bardhe duhet te jete e vendosur tek modemi te porta **“COM1”** dhe tek kasa tek porta me **shenjen e peshores** siper.
5. Ndizni modemin duke mbajtur butonin e kuq shtypur deri sa te degjoni nje sinjal akustik **“BIP”** dhe ne modem te pulsoje drita jeshile.
6. Prisni derisa te pulsoje njehere drita e kuqe qe sinjalizon se tani modemi eshte gati te prese komanda nga kasa.
7. Shtypim butonin **MODE** derisa ne ekran te dale **“SHITJE ....”**
8. Shtypim ne tastiere **11** dhe me pas butonin **“TL”**
9. Ne ekran do dale shkrimi **“Dergo gjithë Z Raportet”**
10. Shtypni perseri **“TL”** dhe prisni derisa te behet transmetimi ok.
11. Mos kryeni asnje veprim tjetër ne kase apo ne modem nderkohe qe kryhet transmetimi.

## 9. PRINTIM RAPORTI PERIODIK

Permbledhja e raportimeve ditore te nje periudhe te caktuar mund te nxirret nga kasa me ane te procedures se meposhtme:

1. Shtypim **“MODE”** derisa ne ekran te dale shkrimi **“MF”**
2. Shtypim numrin 9 kater here **“9999”**
3. Miratojme me butonin **“CLK”**
4. Shtypim numrin 1 dhe me pas butonin **“ST”**
5. Vendosim daten e fillimit te permbledhjes se raporteve ne formatin dite, muaj, vit (psh. Per daten 1 janar 2015 do te shkruajme **010115**)
6. Miratojme me butonin **“QTY”**
7. Vendosim daten e mbarimit te permbledhjes se raporteve ne formatin dite, muaj, vit (psh. Per daten 31 janar 2015 do te shkruajme **310115**)
8. Shtypim butonin **“VD”**

Presim derisa te mbaroje e gjithe permbledhja

## 10. LEXIM KOPJE E KUPONIT (KOPJE JO TATIMORE)

Per te nxjerre nje kopje te nje kuponi qe sapo keni prere, apo te nje kuponi qe keni prere kohe me pare duhet te ndiqni proceduren e meposhtme:

1. Shtypim **“MODE”** derisa ne ekran te dale shkrimi **“LEXIM”**
2. Shtypim numrin 9 kater here **“9999”**
3. Miratojme me butonin **“CLK”**
4. Shtypim njekohesisht te dy butonat **“ALT”** dhe **“TL”**
5. Shtypim numrin 1 dhe me pas butonin **“ST”**
6. Vendosim daten kur kemi prere kuponin qe duam te nxjerrim ne formatin dite, muaj, vit (psh. Per daten 1 janar 2015 do te shkruajme **010115**)
7. Miratojme me butonin **“QTY”**
8. Shtypim numrin **1** dhe pastaj butonin **“+”**
9. Shtypim numrin **100** dhe pastaj butonin **“-”**

## 11. NDRYSHIMI I ORES

Kur ndodh ndryshimi i ores ne dimerore dhe verore (ne muajt Tetor dhe Mars) ne ekran do te shfaqet shkrimi "ORA DIMERORE" ose "ORA VERORE". Per te aktivizuar ndryshimin e ores ne keto momente duhet te shtypni butonin "**ST**".

## 12. PROGRAMIMI I ARTIKUJVE

Ne momentin qe merrni kasen tuaj, artikujt jane hedhur ne kase sipas listes te paraqitur prej jush. Gjate punes tuaj mund te linde nevoja qe te shtoni artikuj te tjere ne pajisje de kjo mund te behet nga tekniku por mund te behet dhe nga vete ju.

Programimi i artikujve behet duke shtypur butonin MODE derisa ne ekran te shfaqet PROG...., futim kodin 9999 dhe miratojme me CLK. Me pas ndjekim hapat si me poshte:

1. Shtypim numrin e artikullit qe doni te shtoni (pra, nese ne kase keni te regjistruar 10 artikuj do te shtypni numrin 11) dhe me pas butonin **PLU**; ne ekran shfaqet numri i artikullit dhe kerkohet cmimi i tij

<b>Artikulli 1</b>	<b>[0011</b>	<b>1]</b>
	<b>[ Cmimi:</b>	<b>0,00]</b>

2. Vendosim cmimin (psh 200) dhe shtypim butonin **ST**.
3. Ne ekran kerkohet numri i departamentit . Vendosim numrin e departamentit (psh 1) dhe shtypim butonin **ST**

<b>[0001</b>	<b>3]</b>
<b>[DEP:</b>	<b>1]</b>

4. Vendosim emrin e artikullit duke ndjekur kodifikimin e germave te tabelës nr.1 (shiko me poshte) dhe shtypim butonin **ST**

<b>[0001</b>	<b>4]</b>
<b>[EMER:</b>	<b>]</b>

5. Vendosim barkod-in e artikullit (ne qofte se ka) dhe shtypim butonin **ST**. Ne qofte se nuk kemi barkod, kalojme tek parametri tjetër duke shtypur butonin **ST**.

<b>[0001</b>	<b>5]</b>
<b>[BK:</b>	<b>0]</b>

6. Ne ekran do te dale sasia dhe do shtypim butonin **ST** per te vendosur te dhenat per artikullin e dyte.

<b>[0001</b>	<b>6]</b>
<b>[SASI</b>	<b>999999, 999]</b>

7. Perserisim hapat 1- 6 per te gjithë artikujt e tjere
8. Per te perfunduar programimin e artikujve shtypim butonin **TL**

### **12.1 Ndryshimi i te dhenave te artikujve**

Shpeshhere nevojitet te ndryshohen disa te dhena per artikujt (psh cmimi). Per te realizuar kete, ndjekim hapat e meposhtme:

1. Shtypim numrin e artikullit te cilit duam t'i ndryshojme te dhenat dhe me pas shtypim butonin **PLU**.
2. Ne qofte se nuk e dime numrin e artikullit te cilit duam t'i ndryshojme te dhenat, shtypim butonin **PLU** dhe me pas shtypim butonin **-%**. Keshtu printohet nje liste me te dhenat e te gjithë artikujve nga e cila mund te mesojme numrin e artikullit te cilit duam t'i ndryshojme te dhenat.
3. Pasi kemi mesuar numrin e artikullit, perserisim hapin 1 dhe me pas bejme ndryshimin e parametrave duke ndjekur hapat e pershkruara ne paragrafin **4.4**
4. Bejme Per te perfunduar ndryshimet, shtypim butonin **TL**

**Kujdes!** Te dhenat e artikujve duhet te ndryshohen menjehere pas raportit fiskal ditor (Z Raport). Ne te kundert nuk eshte e mundur ndryshimi i tyre.

### **TABELA nr . 1**

A 41	B 42	C 43	D 44	E 45	F 46	G 47	H 48	I 49	J 4 <u>A</u>	K 4 <u>B</u>	L 4 <u>C</u>	M 4 <u>D</u>
N 4 <u>E</u>	O 4 <u>F</u>	P 50	Q 51	R 52	S 53	T 54	U 55	V 56	W 57	X 58	Y 59	Z 5 <u>A</u>
a 61	b 62	c 63	d 64	e 65	f 66	g 67	h 68	i 69	j 6 <u>A</u>	k 6 <u>B</u>	l 6 <u>C</u>	m 6 <u>D</u>
n 6 <u>E</u>	o 6 <u>F</u>	p 70	q 71	r 72	s 73	t 74	u 75	v 76	w 77	x 78	y 79	z 7 <u>A</u>

**01** = A

**02** = B

**03** = C

**04** = D

**PAY** = E

**PLU** = F